



SFERAT DHE FORMAT E BASHKËPUNIMIT TË SHKOLLAVE PROFESIONALE DHE KOMPANIVE



Arsim për Punësim
në Maqedoninë e Veriut



Qendra e Arsimit dhe
Aftësimin Profesional



SFERAT DHE FORMAT E BASHKËPUNIMIT TË SHKOLLAVE PROFESIONALE DHE KOMPANIVE

dokument informativ
për operacionalizimin e
bashkëpunimit midis shkollave
të mesme profesionale dhe
kompanive

Autorë:

Mr. Zoran Jovçevski, këshilltar, Qendra e
Arsimit dhe Aftësimin Profesional (QAAP)

Mr. Ardijana Isahi Palloshi, këshilltare, Qendra
e Arsimit dhe Aftësimin Profesional (QAAP)

Redaktimi:

Mr. Ivana Georgievska, eksperte për arsim
profesional dhe trajnim, Projekti "Arsim për
Punësim në Maqedoninë e Veriut"

Dhjetor, viti 2018, Shkup



PARATHËNIE

Rritja dhe zhvillimi dinamik i ekonomisë, teknologjisë dhe tregut global imponojnë ndryshime në procesin arsimor që kërkojnë qasje më të ndryshme në përvetësimin e diturive, shkathtësive dhe kompetencave. Institucionet arsimore nuk janë gjithmonë në gjendje t'u përgjigjen nevojave të shumta të kompanive dhe të ofrojnë shkathtësi të zhvilluara praktike të rinjta dhe të moshuarit që janë të përshtatshme me dinamikën dhe ndryshimet e shpejta dhe të (pa) pritura të ekonomisë dhe teknologjisë. Prandaj, bashkëpunimi mes institucioneve arsimore dhe punëdhënësve është i domosdoshëm, me qëllim që kuadrot që arsimohen përmes arsimit profesional të përvetësojnë kompetenca përkatëse që do të jenë të zbatueshme në vendet e ardhshme të punës.

Për sigurimin e mundësive të nxënësit/nxënëses që praktikisht të përvetësojnë shkathtësi profesionale, por edhe shkathtësi të tjera thelbësore, është përkatëse që trajnimi praktik të zhvillohet në mënyrë të dyfishtë, gjegjësisht me prani të domosdoshme të vendeve reale të punës, krahas kapaciteteve shkollore.

Megjithatë, përveç trajnimit praktik ekzistojnë edhe mënyra dhe forma të tjera në të cilat punëdhënësit mund të kontribuojnë dukshëm në proceset arsimore.

Elaborimi i të njëjtave gjendet në faqet që vijojnë. Lista ka për qëllim që të japë idetë dhe udhëzimet fillestare dhe t'i nxisë mendimet e shkollave dhe të punëdhënësve se në cilat mënyra mund të bashkëpunojnë në synimin e përbashkët: të avancohet cilësia e procesit arsimor në arsimin e mesëm profesional duke u mundësuar nxënësve që të përgatiten në mënyrë përkatëse për tregun e punës.

Ivana Georgievska,
Ardijana Isahi Palloshi
Zoran Jovçevski



SFERA

1



REALIZIM I MËSIMIT DHE TRAJNIMIT PRAKTIK

1.1. MËSIMI PRAKTIK

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
<p>Mësimi praktik paraqet një nga format e trajnimit të nxënësve në arsimin e mesëm profesional. Realizohet në vazhdimësi gjatë vitit shkollor sipas programit të përpiluar për mësim praktik dhe me numër të orëve të parapara në planin mësimor. Në arsimin profesional trevjeçar më shpesh realizohet në të tre vitet, ndërsa në arsimin profesional katërvjeçar zakonisht realizohet në vitin II, III dhe IV të arsimit. Realizimi bëhet kryesisht në shkollë, por një pjesë e tij mund të zhvillohet jashtë saj, gjegjësisht nëpër kompani. Programi i mësimit praktik i ndjekë tërësitë e leksioneve programore që mësohen në lëndët profesionale-teorike gjatë vitit përkatës shkollor.</p>	<p>Shkolla e tregon arsyen e ekzistimit të saj me atë që zbaton dhe zhvillon forma dhe metoda të punës edukative-arsimore me të cilat mësimin e lidh me zbatimin praktik të njohurive në punën prodhuese dhe në punë tjera të dobishme shoqërore.</p>	<p>Punëdhënësit e kanë mundësinë të marrin fuqi punëtore konkurruese, që është e trajnuar në nivel të profesioneve, ndërsa me këtë edhe fuqi punëtore që ka fituar dhe posedon fleksibilitet më të madh dhe adaptim për punë në vende të ndryshme pune.</p>	<p>Nxënësit kanë mundësi ta shqyrtojnë ndërlidhjen e teorisë me praktikën dhe t'i zbatojnë njohuritë e fituara profesionale praktike-teorike.</p> <p>Gjithashtu, kanë mundësi të fitojnë shkathtësi që do t'u shërbejnë të kycen në tregun e punës, gjegjësisht për punësimin e tyre.</p>

1.2. PRAKTIKA FERIALE

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
<p>Praktika feriale, njëjtë si mësimi praktik, paraqet formë të trajnimit praktik të nxënësve në arsimin e mesëm profesional. Realizohet pas përfundimit të vitit shkollor, gjatë pushimit veror, ndërsa në pajtueshmëri me ditët për praktikë feriale, të parapara në planin mësimor. Më shpesh ky numër lëviz prej pesë deri 20 ditë në vit. Realizimi zhvillohet në kompani.</p> <p>Pas përfundimit të praktikës feriale, nxënësit do të marrin vërtetim nga kompania për praktikë të kryer me sukses, që është kusht për regjistrimin e tyre në vitin e ardhshëm shkollor. Zbatohet në të gjitha vitet shkollore, në pajtueshmëri me planin mësimor. Përrjashtim është vitit i fundit i arsimor.</p>	<p>Komunikim dhe bashkëpunim më i mirë me kompanitë.</p> <p>Ngritje e cilësisë të trajnimit praktik.</p> <p>Shfrytëzimi i kapaciteteve të kompanive për inkuadrim në procesin e marrjes së kompetencave të nxënësit.</p>	<p>Punëdhënësit kanë mundësi të hapura të ndikojnë në cilësinë e arsimit profesional.</p> <p>Mundësi të hapura që kompanitë të sigurojnë informacione kthyes për shkollat profesionale në lidhje me përshtatjen e kuadrove që arsimohen në ato shkolla.</p>	<p>Zhvillimin e ndjenjës së përkatësisë ndaj një punëdhënësi të caktuar (kompani, tregtar-individ, institucion dhe të ngjashme).</p> <p>Shqyrtimi i zbatimit operues të njohurive të fituara në shkollë edhe nga aspekti teorik edhe nga aspekti praktik.</p> <p>Mundësi të fitojnë shkathtësi praktike në kushte reale, të mësuar prej mjeshtërve/profesionistë me përvojë.</p> <p>Marrja dhe zhvillimi i kompetencave kyçe në një kompani reale (lloje të ndryshme të komunikimit, zgjidhjen e problemeve, disiplinë në kryerjen e detyrave të punës, iniciativa, kompetenca digjitale, shkathtësi sociale dhe të ngjashme).</p>

1.3. MËSIMI NËPËRMJET PUNËS TE PUNËDHËNËSI (MNP)

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
<p>Mësimi nëpërmjet punës paraqet mësim në vendin e punës në kompani, punëtori artizanale apo në organizata tjera. Nxënësve u ofron mundësi për fitimin e përvojës në vend pune nga jeta reale, që u mundëson njohuritë e marra në shkollë t'i lidhin me punën reale dhe me mundësitë e ardhshme profesionale dhe të karrierës.</p> <p>Mund të realizohet në kuadër të të gjitha formave të trajnimit praktik të nxënësve, në pajtueshmëri me programin që u përshtatet kushteve në kompani, si dhe me qëllimet dhe rezultatet e planifikuara që duhet të arrihen gjatë realizimit të mësimin përmes punës.</p>	<p>Shkolla ka bashkëpunim të përmirësuar me kompanitë.</p> <p>Rritje e cilësisë të trajnimit praktik. Marrje e informacioneve relevante për ngjarjet në tregun e punës dhe ndjekjen e ndryshimeve.</p> <p>Rritje e informimit të mësimdhënësve për teknologjitë e reja, zhvillimet dhe trendet.</p>	<p>Punëdhënësit kanë mundësi për pjesëmarrje aktive në realizimin e procesit arsimor.</p> <p>Rritje e kompetencave të fuqia e ardhshme punëtore.</p> <p>Rekrutim i kuadrove të reja dhe mundësi për zgjedhjen e fuqisë së ardhshme punëtore.</p> <p>Promovim i kompanisë në mjedis lokal dhe më gjerë.</p> <p>Mundësi për realizimin e projekteve të përbashkëta mes shkollave dhe kompanive.</p>	<p>Njohuritë dhe shkathtësitë që i kanë marrë në orët në shkollë t'i përdorin në procesin real të punës. Zhvillimin e kompetencave të përgjithshme dhe reale të nevojshme për kycje të pavarur në procesin e punës.</p> <p>Mësim dhe shfrytëzim i terminologjisë profesionale në kushte reale.</p> <p>Punë me vegla, mjete, aparate dhe pajisje specifike. Punë me ekip me qasje problematike ndaj punës. Shqyrtimi i rëndësisë të respektimit të rregullave të sigurisë dhe mbrojtjes gjatë punës, mbrojtjes nga zjarri, NASSR MKC apo të tjera.</p> <p>Mundësi më të mëdha për zgjedhjen e profesioneve dhe zhvillim adekuat profesional personal.</p>

1.4. PRAKTIKA PROFESIONALE

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
<p>Praktika profesionale përfaqësohet në sektorët dhe profilet arsimore që karakterizohen me punë sezonale në procesin e prodhimitarisë (në sektorin bujqësi-veterinari dhe pylltari-prodhimi i drurit). Praktika realizohet gjatë vitit shkollor në ditët kur puna sezonale në prodhimitari nxënësve u mundëson inkuadrimit e drejtpërdrejt në procesin e prodhimitarisë. Në planin mësimor fondi vjetor për praktikën profesionale është shprehur në ditët e punës në vitin e parë, të dytë dhe të tretë.</p> <p><i>Praktika profesionale realizohet në kuadër të plan-programeve joformale, kur aplikimi i saj përfundon për dy vite, pra me mbarimin e vitit shkollor 2020/2021.</i></p>	<p>Shkolla ka bashkëpunim të përmirësuar me kompanitë.</p> <p>Kualitet i shtuar i trajnimit praktik. Fitohen informacione relevante për ngjarjet në tregun e punës dhe ndiqen ndryshimet.</p>	<p>Punëdhënësit kanë mundësi të hapura të ndikojnë në cilësinë e arsimit profesional.</p> <p>Rekrutimi i kuadrove të reja dhe mundësi për zgjedhjen e fuqisë së ardhshme punëtore.</p>	<p>Perceptimi i aplikimit operative të njohurive të fituara në shkollë, edhe nga aspekti teorik edhe nga ai praktik.</p> <p>Mundësi që nxënësit të përvetësojnë shkathtësi praktike në kushte reale, të mësuara nga mjeshtër/ profesionistë me përvojë.</p>

1.5. VIZITË NJËDITORE TE PUNËDHËNËSI

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
<p>Vizitën njëditore te punëdhënësi e inicion mësimdhënësi i lëndës profesionale-teorike apo ai i mësimit praktik. Vizita zgjatë së paku një orë deri në një ditë pune, varësisht nga koha e disponueshme apo nga natyra e procesit ose e shërbimit. Qëllimi i vizitës është të vëzhgohet një proces, prodhim apo shërbim konkret, që nxënësit kanë mësuar në kuadër të lëndëve mësimore profesionale-teorike, në mësimin praktik apo në ushtrime.</p>	<p>Lëndët profesionale bëhen më interesante sepse nxënësit kanë pasqyrë më reale për një vend pune të caktuar, për një proces, prodhim apo shërbim. Për mësimdhënësin është më lehtë t'i arrijë rezultatet e pritura.</p>	<p>Punëdhënësit zhvillojnë bashkëpunim dhe komunikim me të rinjtë, me të cilën gjë e promovojnë kompaninë. Me përmirësimin e komunikimit, kompania mund t'i motivojë të rinjtë për punë në veprimtarinë e caktuar.</p>	<p>Takimi me punëtorët në vendin e punës mund t'i frymëzojë të rinjtë.</p> <p>Mësimi është më relevant dhe fitohet pasqyrë e qartë për profesionin. Ndihmohet orientimi profesional i të rinjve.</p>

1.6. VËZHIMI I VENDIT/VENDEVE TË PUNËS NË KOMPANI

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
<p>Vëzhgimin e vendeve të punës e organizon shkolla në bashkëpunim me kompaninë. Nxënësi i lejohet të qëndrojë në kompani me qëllim që të vëzhgojë vende pune të ndryshme që kanë lidhje me profesionin, respektivisht kualifikimin për të cilën ai vijon shkollimin. Gjatë vëzhgimit, nxënësi/nxënësja i evidentojnë specifikat e vendit të punës, sa u përket kushteve të punës, aktivitetet që i kryen punëtori, mjetet dhe pajisjet që i shfrytëzon gjatë punës, procedurat e sigurisë dhe ngjashëm. Proces i vëzhgimit të vendeve të punës zgjattë më shumë se një ditë, zakonisht prej 3 deri 5 ditë, varësisht nga numri i vendeve të punës.</p>	<p>Mësimdhënësit do të kuptohen më mirë kur do të theksojnë rëndësinë dhe nevojën e njohurive dhe shkathtësive të caktuara që duhet t'i posedojnë nxënësit për zhvillimin e tyre të ardhshëm profesional. Tërësia e asaj që duhet të mësohet do të shqyrtohet dhe me këtë do të rritet edhe motivimi edhe të mësimdhënësit edhe të nxënësit. Shkolla do të mund të arrijë rezultate më të mira.</p>	<p>Punëdhënësit fitojnë kuadro që kanë interes dhe pasqyrë rreth asaj se çfarë do të kishin punuar në të ardhmen.</p> <p>Po ashtu, punëdhënësit mund të kenë mundësi të ndikojnë rreth përcaktimit të të rinjve që të jenë punëtorët e tyre të ardhshëm nëpërmjet masave të ndryshme stimuluese.</p>	<p>Në përputhje me afinitetet dhe njohuritë e tyre të fituara në një kualifikim të caktuar, nxënësit kanë mundësi të shohin se ku mund të gjenden si të punësuar të ardhshëm apo t'i përcaktojnë vendet e punës të cilat nuk do të kishin qenë në gjendje t'i punojnë. Kjo do të thotë se ky aktivitet mund t'u ndihmojë në zhvillimin e tyre profesional në hapjen e horizontit të tyre për avancim në karrierë.</p>

1.7. VIZITA E PUNËDHËNËSIT NË ORËN MËSIMORE/MYSASFIR NË ORËN MËSIMORE

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
<p>Shkolla mund të organizojë që një përfaqësues i një kompanie/ punëdhënës i caktuar të marrë pjesë në orën mësimore në lëndën profesionale-teorike. Përfaqësuesi i kompanisë mund t'i prezantojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> → specifikat e një procesi konkret teknologjik, një prodhim apo shërbim ku punon ai, → karrierën e tij personale dhe rrugën si ka arritur deri tek ajo pozitë. <p>Prezantimi mund të incizohet dhe të shfrytëzohet për tjetër herë, ndërsa i njëjti mund të ndahet edhe me shkolla tjera.</p> <p>Punëdhënësi dhe mësimdhënësi mund të merren vesh që një leksion të caktuar mësimor ta ligjërojë punëdhënësi.</p>	<p>Lëndët profesionale bëhen më interesante sepse gjërat prezantohen nga një aspekt dhe perspektivë tjetër. Kjo formë e bashkëpunimit i mundëson shkollës të njihet me aktualitetet dhe praktikat më të mira. Incizimi mund të përdoret më shumë herë edhe me nxënës tjerë.</p>	<p>Punëdhënësi, duke ndarë përvoja jetësore, u ndihmon nxënësve të kuptojnë më shumë për drejtimin/ profesionin dhe për zhvillimin e karrierës.</p> <p>Në këtë mënyrë nxitet interesi te nxënësit për atë drejtim/profesion.</p> <p>Fuqia e ardhshme punëtore është në rrjedhë me proceset aktuale nëpërmjet përmbajtjeve të ndara.</p>	<p>Nxënësit dëgjojnë për përvojat e drejtpërdrejta nga punëtorë më përvojë. Ky aktivitet ndihmon që t'u bëhet e qartë se çfarë pritet nga ata kur do të marrin vendin e punës. Janë të gatshëm për përzgjedhjen e karrierës.</p>

1.8. ORË TË LIRA TË SHKOLLËS/PËRMBAJTJE TË PROGRAMUARA NGA SHKOLLA

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
<p>Orët e lira/përmbajtjet e programuara nga shkolla janë sferë arsimore me të cilën u mundësohet nxënësve të mësojnë edhe sfera tjera jashtë atyre të obliguarave, nëse e duan të njëjtën. Orë të këtilla mund të realizohen për çfarëdo kualifikimi në përputhje me planin mësimor. Nëse shkolla dhe kompania vlerësojnë se një sferë e caktuar është me interes të përbashkët për të mësuar dhe për ta realizuar, ata mund të hartojnë program sipas drejtimeve për programimin e orëve të lira dhe ta dorëzojnë në QAAP për miratim. Pas mendimit pozitiv, e njëjta mund të realizohet.</p>	<p>Sjellje fleksibile e shkollës lidhur me nevojat e treguara të komunitetit lokal apo të ndonjë kompanie.</p> <p>Bashkëpunim dinamik me partnerët socialë nga veprimtaria gjegjëse.</p> <p>Mundësi për ndjekjen e trendeve bashkëkohore të tregut të punës dhe për të mësuar nga kompanitë.</p>	<p>Përmbushje e nevojave të tyre specifike lidhur me kompetivitetin e fuqisë së ardhshme punëtore.</p> <p>Siguri e shtuar e kompanisë lidhur me ekzistimin e fuqisë punëtore adekuate.</p>	<p>Zgjerimi dhe thellimi i diturive, qëndrimeve dhe shkathtësive në një sferë adekuate.</p> <p>Përvetësimi i kompetencave në përputhje me ndryshimet dinamike të tregut të punës.</p> <p>Përmbushja e interesave individuale për të mësuar.</p>



SFERA

2



KUADRI MËSIMOR DHE KUADËR TJETËR PROFESIONAL

2.1. TRAJNIMI I MËSIMDHËNËSVE NË KOMPANI

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
Bashkëpunimi i shkollës me kompaninë me qëllim trajnimin e mësimitdhënësve të punëdhënësi luan rol të rëndësishëm në arsimin profesional dhe trajnimin. Ky bashkëpunim kontribuon në realizimin më cilësor të programeve mësimore të lëndëve profesionale-teorike dhe trajnimit praktik. Me këtë zgjerohen njohuritë dhe përvetësohen kompetencat e mësimitdhënësit në sferën profesionale.	Mësimitdhënësit përsosën në kompani, ku njoftohen me teknologjitë, trendet dhe risitë më të reja në sektor dhe me zhvillimin dhe funksionimin e organizimit të punës në procesin e punës. Me këtë përvetësohen me kompetenca për realizimin më cilësor të programeve, që do të thotë produksion i kuadrit të ardhshëm me shkathtësi të përmirësuar për punësim.	Punëdhënësit kanë mundësi të marrin informacione të drejtpërdrejta për zhvillimet në arsimin profesional. Fitojnë mundësi të ndikojnë në cilësinë e punës së mësimitdhënësve dhe, me vetë këtë, të ndikojnë për dituri dhe shkathtësi më të mira të nxënësit – që janë fuqia e ardhshme punëtore e tyre. Të dyja palët fitojnë mundësi për shkëmbimin e përvojave dhe ideve.	Nxënësist kanë mësimitdhënësi më cilësorë, që do të mund të organizojnë mësimitdhënie më interesante dhe më kompletuar. Gjatë kësaj, u jepet mundësia që të shohin më mirë lidhshmërinë ndërmjet teorisë dhe praktikës dhe, me këtë, njohuritë dhe shkathtësitë e tyre të fituara do të kishin vlerë më të madhe shfrytëzimi.

2.2. TRAJNIMI NË SHKOLLË PËR SHFRYTËZIMIN E PAJISJES

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
<p>Në veprimtaritë prodhuese dhe shërbyese, kompanitë zakonisht shfrytëzojnë pajisje më të sofistikuara dhe bashkëkohore dhe janë në rrjedhë me zhvillimin teknik-teknologjik. Shkollat, në krahasim me kompanitë, më ngadalë e ndjekin zhvillimin e teknikës dhe teknologjisë. Gjatë furnizimit të pajisjes së re në shkollë për shfrytëzim në mësim, përfaqësues të kompanive mund të kryejnë trajnim të kuadrit mësimor për aplikimin e pajisjes së re.</p>	<p>Shkolla fiton mësimdhënës të trajnuar për ta përdorur pajisjen e re ku, gjatë kësaj, nxënësve u mundësohet të përvetësojnë kompetencat e nevojshme, duke e shfrytëzuar pajisjen gjatë realizimit të trajnimit praktik.</p>	<p>Punëdhënësit fitojnë kuadro të përgatitur që janë trajnuar paraprakisht në shkollë, e më pas vazhdojnë me punë të punëdhënësi.</p>	<p>Mësimdhënës të trajnuar krijojnë nxënës të përgatitur. Duke e ushtruar pajisjen në shkollë, nxënësit fitojnë shkathtësi për punë me atë pajisje.</p>



SFERA

3



PAJISJA, MJETET DHE MATERIALET

3.1. SPONZORIMI DHE DONIMI I PAJISJES, MJETEVE DHE MATERIALEVE

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
Punëdhënësit mund të donojnë dhe të sponsorizojnë furnizim të pajisjes funksionale për shkollat, në përputhje me Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtarinë publike (Gazeta Zyrtare nr. 7/06, 86/08, 51/2011, 28/14 dhe 153/ e dt. 4.9.2015). Shkollat mund ta shfrytëzojnë pajisjen për ushtrime të nxënësve.	Shkolla fiton pajisje adekuate për realizimin praktik dhe për arritjen e rezultateve nga mësimi në procesin mësimor. Posedon pajisje në të cilën nxënësit mund të ushtrojnë dhe të fitojnë shkathtësi.	Në përputhje me Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtarinë publike (Gazeta Zyrtare nr. 7/06, 86/08, 51/2011, 28/14 dhe 153/ e dt. 4.9.2015) punëdhënësit kanë përfitime tatimore.	Nxënësit e përdorin pajisjen e fituar. Duke ushtruar në pajisjen e shkollës, nxënësit përvetësohen me shkathtësi praktike adekuate për punë me pajisjen.

3.2. PËRKRAHJE NË MIRËMBAJTJEN E PAJISJES SË SHKOLLËS

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
<p>Kuadri teknik i kompanive, që kujdeset për mirëmbajtjen e pajisjes, mund të angazhohet për riparimin, servisimin dhe rimontimin e pajisjes së amortizuar në shkollë. Shkolla dhe kompania mundet së bashku të planifikojnë dhe të realizojnë procesin e mirëmbajtjes së pajisjes shkollore.</p>	<p>Shkolla fiton mirëmbajtje cilësore të pajisjes shkollore. Pajisja e shkollës vazhdimisht do të jetë funksionale.</p>	<p>Nxënësit realizojnë ushtrime në shkollë duke shfrytëzuar pajisjen shkollore, ku gjatë kësaj janë më të përgatitur kur do të hyjnë në një kompani, qoftë në punë apo për realizimin e trajnimit praktik.</p>	<p>Nxënësit kanë qasje vazhdimisht në pajisjen funksionale.</p> <p>Duke ushtruar në pajisjen e shkollës, nxënësit përvetësohen me shkathësi për punë dhe janë më të përgatitur për punë te punëdhënësi.</p>

3.3. PËRGATITJA E MATERIALEVE PËR MËSIM

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
<p>Punëdhënësit mund të sigurojnë resurse apo materiale për mësim me qëllim që aktivitet për mësim të jenë më bashkëkohore dhe më të dobishme.</p> <p>Punëdhënësit mund të jenë edhe pjesë e ekipit të autorëve gjatë të shkruarit/përpilimit materialeve/ librave për mësim. Punëdhënësit mund të sigurojnë video-materiale të incizuara me procese dhe/ose shërbime, material promovues, ekzemplarë të derivateve, gjysmë-prodhime dhe prodhime e ngjashëm.</p>	<p>Shkolla e zgjeron vëllimin e materialeve dhe të mjeteve didaktike që i shfrytëzon.</p> <p>Siguron material relevant dhe aktual për mësim.</p>	<p>Punëdhënësit përmes përgatitjes së materialeve për mësim e kursejnë kohën e tyre për sqarim gjatë trajnimit praktik dhe fokusohen në realizimin e detyrës konkrete.</p>	<p>Të mësuarit është më relevantja, ndërsa nxënësit fitojnë pasqyrë më të qartë për proceset dhe për shërbimet. Me shfrytëzimin e materialeve për mësim, ata kanë mundësi t'i pasurojnë kompetencat e tyre edhe jashtë kohës së obliguar për trajnim praktik.</p>



INICIATIVAT E PËRBASHKËTA

4.1. HARTIMI I DOKUMENTEVE PROGRAMORE

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
Shkollat dhe kompanitë mund të propozojnë dhe të iniciojnë hartimin e dokumenteve të ndryshme programore, si: standarde për profesione, standarde për kualifikime, programe mësimore në sfera arsimore të ndryshme, programe për arsimin e të rriturve dhe ngjashëm. Dokumentet e këtilla programore duhet të mbështeten nga institucionet përkatëse të sistemit, si MASH, BZHA, QAAP etj.	Shkolla fiton mbështetje nga kompanitë dhe për produksionin e dokumenteve programore, realizimi i të cilave do të kontribuojë në sigurimin e kuadrit në përputhje me nevojat e tregut të punës.	Punëdhënësit marrin pjesë drejtpërdrejt në hartimin e dokumenteve programore në përputhje me nevojat e tyre të identifikuara. Me këtë u jepet mundësia që drejtpërdrejt të ndikojnë në cilësinë e procesit të mësimit në përputhje me kërkesat e tyre.	Optimizim i rezultateve të vendosura që duhet t'i arrijnë nxënësit/ pjesëmarrësit gjatë arsimit të tyre profesional sipas nevojave në realitet.

4.2. FUSHATA PËR KUALIFIKIME DHE MBËSHTETJE NË ORIENTIMIN PROFESIONAL

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
<p>Planifikohet fushatë e përbashkët për një veprimtari të caktuar, respektivisht kualifikim, që nevojitet në tregun e punës, e që ofrohet nga një shkollë e caktuar. Fushata mund t'i referohet për kualifikim nga arsimi formal apo nga ai joformal.</p> <p>Fushatë e përbashkët mund të realizohet edhe për kualifikimet ekzistuese, ku, gjatë kësaj, promovohen përvoja të mira nga ndonjë bashkëpunim i realizuar dhe prezantohen nxënës të suksesshëm që janë përvetësuar me kualifikime.</p> <p>Fushata mund të realizohet nëpërmjet medimeve të ndryshme dhe me përdorimin e teknikave të ndryshme: afishe të shtypura dhe pamflete, prezantime të përbashkëta, pjesëmarrje/ prezantime në medime, pjesëmarrje e përbashkët në panaire dhe ngjashëm.</p>	<p>Shkolla ka mundësi të rritë atraktivitetin e kualifikimeve që i ofron dhe të rritë shikueshmërinë e vet. Me këtë do të mund të rritet numri i nxënësve/ pjesëmarrësve në arsimin formal apo joformal dhe do të mund të rritet rejtingu dhe renojeja e shkollës.</p>	<p>Punëdhënësit e promovojnë kompaninë dhe kontribuojnë në krijimin e kuadrove kompetentë të arsimuar apo/ edhe të trajnuar për përfshirje në procesin e punës.</p>	<p>Nxënësit/pjesëmarrësit fitojnë pasqyrë më të qartë në cilën kompanitë apo rreth asaj se në çfarë lloj kompanie mund të punësohen pas përfundimit të arsimit apo trajnimit të caktuar.</p>



SFERA

5



SIGURIMI I CILËSISË

5.1. PËRPILIMI I INSTRUMENTEVE PËR KONTROLLIN E ARRITJEVE TË NXËNËSVE GJATË TRAJNIMIT PRAKTIK TEK PUNËDHËNËSI

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
Kontrolli i arritjeve të nxënësve është segment i rëndësishëm i trajnimit praktik. Për t'u perceptuar efektet e mësimit nëpërmjet punës, palët e përfshira shfrytëzojnë instrumente për monitorimin, evidentimin dhe për vlerësimin e arritjeve të nxënësve.	<p>E monitoron, e vlerëson dhe e evidenton procesin e trajnimit praktik në kompani me qëllim që në kohë të mënjanohen pengesat që janë paraqitur gjatë realizimit, si dhe të parashikohen masat korrektuese për gjeneratat e ardhshme.</p> <p>Me këtë aktivitet shkolla fiton edhe dëshmi relevante për avancimin e nxënësve, si dhe për formimin e notës përfundimtare të nxënësit.</p>	Punëdhënësit kanë instrumente (check-lista, kriteret dhe ngjashëm), me çka sigurohet vlerësimi relevant i transparent i nxënësve.	Nxënësit marrin vlerësim real dhe adekuat të rezultateve të arritura. Dhe, gjatë kësaj, marrin orientime ku dhe si të përmirësohen në të ardhmen.

5.2. REALIZIMI I PJESËS PRAKTIKE TË PROVIMIT PËRFUNDIMTAR DHE/OSE MATURËS SHTETËRORE/PROFESIONALE

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PËRPARËSITË PËR SHKOLLËN	PËRPARËSITË PËR PUNËDHËNËSIT	PËRPARËSITË PËR NXËNËSIT
<p>Gjatë realizimit të pjesës praktike të provimit përfundimtar apo maturës shtetërore/profesionale marrin pjesë edhe punëdhënësit. Rekomandohet që pjesa praktike të realizohet në kompani. Planifikimi, organizimi dhe realizimi i provimit bëhen së bashku. Shkolla dhe punëdhënësit së bashku i definojnë detyrat e provimit se dhe bashku i hartojnë kriteret e vlerësimit. Përfaqësues i punëdhënësve merr pjesë në notimin e nxënësve.</p>	<p>Shkolla fiton siguri se krijon kuadro të aftë për punë. Realizon bashkëpunim me kompanitë ku fiton indikatorë ku duhet të përmirësohet që të sigurohen rezultate më të mira të nxënësve të ardhshëm.</p>	<p>Gjatë realizimit të pjesës praktike të provimit, punëdhënësit mund të këqyrin cilësinë e secilit nxënës. Punëdhënësi mund t’u ofrojë punësim nxënësve për të cilët konsideron se janë relevantë për kompaninë, ku, gjatë kësaj, do të fitojë kuadër cilësor të trajnuar.</p>	<p>Kjo është mundësi e mirë që nxënësit t’i shfaqin shkathtësitë dhe kompetencat e tyre. Nëse tregojnë rezultate të mira, mund të marrin oferta për punësim.</p>

